



BASHKIA PUKË



# PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË BASHKISË PUKË

P ë r m b l e d h j e

**Përgatitur nga:** BASHKIA PUKË

**Mbështetur nga:** Intercooperation Albania, Programi për Decentralizimin dhe Zhvillimin Vendor ( dldp )  
Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Shqipëri  
URBAPLAN, Zvicer

**Financuar nga:** SDC – Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim

**Pukë - 2008**

**Realizimi Grafik:** CREOstd

**Shtypur në:** Botime AFROJDIT



Schweizerische Eidgenossenschaft    Swiss Cooperation Office Albania  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

## Tabela e Përmbajtjes

Hyrje .....	4
Fjala e Përshëndetjes .....	5
Çfarë është dhe Çfarë Përfaqëson PSZH për Bashkinë e Pukës? .....	6
Profili i Bashkisë Pukë .....	7
Bashkia Pukë në Kontekstin Rajonal .....	9
Drejtimet e Zhvillimit nga Grupi i Qytetarëve .....	10
Vizioni i Zhvillimit të Bashkisë Pukë .....	10
Objektivat e Përgjithshëm të Zhvillimit të Bashkisë Pukë .....	11
Zhvillimi Ekonomik .....	12
Menaxhimi i Tokës .....	13
Përmirësimi i Infrastrukturave dhe Shërbimeve .....	14
Forcimi i Qeverisjes së Mirë .....	15
Mobilizimi i Burimeve Financiare .....	16
Instrumentat e Menaxhimit të Territorit .....	17
Forma dhe Metodologjia e Zbatimit të PSZH .....	21

## Hyrje

Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë Pukë, e parashtruar në këtë dokument, vjen në kuadër të **Programit për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor (DLDP)** në rajonin verior të Shkodrës.

Bashkia Pukë është një ndër tetë njësite partnere të qeverisjes vendore përfituese të këtij programi, krahas Bashkive Shkodër, Vau i Dejës, Fushë-Arrëz, Koplik si dhe Komunave Velipojë, Guri i Zi e Dajç

Ky Program synon drejt përmirësimit të qeverisjes në nivelin vendor; konkretisht, përmirësimin e komponentëve të qeverisjes vendore, menaxhimit dhe administrimit të shërbimeve, duke mbështetur proceset e decentralizimit dhe transicionit në vend, si dhe zhvillimin e qëndrueshëm urban e gjithëpërfshirës të zonave të synuara.

Hartimi i Planeve Strategjike të Zhvillimit për njësitë vendore nëpërmjet një procesi përgatitor të hapur me pjesëmarrjen e qytetarëve, përbëjnë boshtin kryesor të Programit. Qëllimi është pajisja e autoriteteve vendore përkatëse me një dokument bazë strategjik, i cili identifikon prioritetet kyç të zhvillimit për njësinë vendore përfituese dhe orienton zhvillimin ekonomik, përmirësimin e infrastrukturave fizike dhe sociale, shpërndarjen e shërbimeve publike, planifikimin dhe menaxhimin e territorit etj.

Në të janë përfshirë gjithashtu përfaqësues të administratës vendore, këshillit vendor, grupe të ndryshme interesi vendor, përfaqësues të Qarkut të Shkodrës si një partner i rëndësishëm në zbatimin e mëtejshëm të këtij dokumenti, përfaqësues të organizatave jofitimprurëse (OJF) si dhe partnerë të tjerë që janë duke ushtruar veprimtarinë e tyre si shoqëri civile në zonat përkatëse.

Nxjtja e pjesëmarrjes së komunitetit vendor, bazuar në forma jodiskriminuese dhe paanshmëri në lidhje me moshën, gjininë, racën, etninë, përkatësinë fetare apo bindjet politike, i ka shërbyer qëllimit për të siguruar legjitimitet dhe konsensus ndërmjet palëve lidhur me Planin, afrimin e komunitetit në vendimmarrje, rritjen e nivelit të transparencës së autoriteteve vendore gjatë ushtrimit të detyrave të veta administrative dhe shkallës së ndërgjegjësimit mbi gamën e shqetësimeve dhe pritshmërive që mbart komuniteti vendas, të gjitha këto si elemente të rëndësishme për një qeverisje të mirë.





## Fjala e Përshëndetjes



Ka më se një vit tashmë që Bashkia Pukë është angazhuar në një projekt tepër të rëndësishëm për zonën dhe komunitetin që përfaqëson. Në sajë të bashkëpunimit me Intercooperation Albania, një organizatë zvicerane që funksionon në Rajonin e Shkodrës, si dhe me Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, u bë e mundur përgatitja e Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Pukë, duke finalizuar kështu një nga dokumentet më të rëndësishëm strategjikë të kësaj njësie vendore për vitet në vazhdim.

Përgatitja e këtij dokumenti u konceptua nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me partnerët dhe aktorët kryesorë në Bashkinë dhe qytetin e Pukës. Në këtë kuadër u angazhuan përfaqësuesit kryesorë të drejtorive në qytet, të shëndetësisë, arsimit, si dhe përfaqësues të administratës së Bashkisë dhe Këshillit Vendor. Angazhimi i tyre gjatë gjithë procesit të përgatitjes së Planit Strategjik të Zhvillimit shërben si shembull i mirë i transparencës si dhe garanton përmbushjen e detyrimeve që ky Plan imponon si për administratën vendore në këtë Bashki, ashtu edhe për grupet e interesit apo për vetë banorët.

Duke falënderuar të gjithë ata që dhanë kontributin për përgatitjen e këtij dokumenti strategjik si dhe institucionet mbështetëse si Intercooperation Albania dhe Co-PLAN, shpreh angazhimin tim personal si dhe të Bashkisë që unë drejtoj për zbatimin rigoroz të përgjegjësive dhe detyrave që imponon Plani Strategjik i Zhvillimit.

Me respekt!

**RUSTEM STRUGAJ**  
Kryetari i Bashkisë Pukë

## Çfarë është dhe Çfarë Përfaqëson PSZH për Bashkinë e Pukës?

**Një plan novator;** është hera e parë që Bashkia Pukë harton një dokument strategjik zhvillimi duke evidentuar në këtë rast një arritje të rëndësishme për këtë njësi vendore, e cila hap rrugën për një përjasje më të organizuar dhe të orientuar drejt zhvillimit.

**Një plan produkt dhe proces;** ky Plan Strategjik Zhvillimi, si një mekanizëm institucional, shërben për rritjen e mirëqenies së të gjithë banorëve të Bashkisë Pukë, si edhe përcakton agjendën vendore të zhvillimit. Ajo çka e bën të veçantë është se ky plan nuk është thjesht një produkt, por mbi të gjitha një proces, i cili mundëson krijimin e një vizioni të qartë për të ardhmen duke orientuar potencialet e komunitetit të Bashkisë Pukë për të arritur qëllimet e tyre.

Dokumenti orienton politikat vendore dhe aktivitetet zhvilluese në të ardhmen, ndërkohë që bazohet në nevojat, përparësitë dhe potencialet ekzistuese, të cilat janë evidentuar dhe diskutuar përgjatë një procesi të gjatë konsultash si me qytetarët e Pukës ashtu edhe me grupin e punës të Bashkisë.

**Një plan vizionar;** strategjia e Bashkisë Pukë për të parën herë i përgjigjet ndjesisë vizionare të komunitetit të tij në lidhje me zhvillimin. Nisur nga fakti se në kontekstin shqiptar, edhe pse duke njohur rëndësinë e eksperiencave në fushën e hartimit të dokumenteve strategjike, si në nivelin rajonal ashtu edhe në atë kombëtar, përsëri ka munguar një ndërthurje vizionare e tyre për të shpjeguar se ku dhe si do të orientohen potencialet ekzistuese, ky plan i bashkëngjitet me një ekuilibër më të arritur zhvillimit rajonal duke mundësuar zhvillimin në maksimum në të gjitha fushat përkatëse. Të gjitha veprimet e propozuara i shkojnë për shtat vizionit të dëshiruar në të ardhmen për këtë Bashki si një qendër shumë e rëndësishme turistike për rajonin e veriut të Shqipërisë.

**Një plan pragmatist;** Plani Strategjik i Zhvillimit është konceptuar si një kontratë aksionesh midis autoriteteve dhe qytetarëve, e cila krijon vizionin e përbashkët për zonën e Pukës, specifikon llojin, sasinë dhe cilësinë e zhvillimit të nevojshëm për përbushjen e vizionit dhe kërkon të mbrojtë me çdo kusht mjedisin dhe vlerat. Ndërkohë dokumenti është i fokusuar në ndërtimin e një kuadri pune si për të filluar ashtu edhe për të influencuar procesin e ndryshimit në Bashki, me qëllim mbështetjen e objektivave të gjera ekonomike, sociale dhe mjedisore të komunitetit të Pukës.

**Një plan i përditësuar dhe realist;** ky dokument është i pajisur me imazhe të ndryshme që pasqyrojnë kushtet aktuale në vend dhe tendencat e zhvillimit.

## Profili i Bashkisë Pukë



Puka është një bashki e vogël me rreth 5,600 banorë. Bashkia Pukë është qendër Prefekturë e Rrethit Pukë; ajo ndodhet në një terren të thyer malor në pjesën veriperëndimore të vendit dhe kufizohet me këto njësi: në veri me Komunën e Qelzës dhe fshatin Kabash të komunës Rrapë; në lindje e verilindje me Komunën Rrapë; në jug me Komunën Gjegjan; në perëndim e veriperëndim me Komunën Luf-Qerret. Ndërsa si rreth, Puka kufizohet në veri me Tropojën e Hasin, në lindje me Kukësin, në jug me Mirditën dhe në perëndim me Lezhën dhe Shkodrën.






Për sa i përket zhvillimit të saj historik, Puka si qytet ka një vazhdimësi rreth dymijëvjeçare. Në trafikun rrugortë natyrë ekonomike dhe ushtarake Adriatik-Dardani dhe Maqedoni-Serbi, që prej antikitetit e më vonë në Mesjetë, duke përfituar nga vendndodhja e favorshme gjeografike, Puka ka luajtur një rol të veçantë në lidhjen e viseve shqiptare veri-lindje-perëndim. Puka është sot një stacion i rëndësishëm verior përgjatë rrugës kombëtare Shkodër-Kukës e cila vazhdon në Kosovë.



Një veçori pothuajse përcaktuese në zhvillimin e Pukës është terreni shumë i thyer malor i saj, në lartësinë mesatare 820m mbi nivelin e detit. Nga njëra anë, terreni malor dhe infrastruktura e dobët ndërqytetëse nuk e mbështesin si duhet komunikimin efikas të Bashkisë Pukë me disa qendra/qytete të populluara në rajonin verior, duke pasur parasysh dhe distancat e konsiderueshme me to, si për shembull: Shkodër (60 km), Lezhë (80 km), Kukës (90 km).

Në aspektin tjetër pozitiv, terreni malor i Pukës është shumë i përshtatshëm për zhvillimin e turizmit malor; krahas pasurive dhe burimeve natyrore me vlera të mëdha ekonomike që gjenden brenda hapësirës gjeografike të Pukës, kryesisht pyje natyrore, bimë mjekësore, pasuri nëntokësore minerare, etj.

Nr.	Emri	Vlera / karakteristika
1	Statusi Ligjor dhe Administrativ	Bashki
2	Vendndodhja	Qarku Shkodër
3	Sipërfaqja totale	26.16 km <sup>2</sup>
4	Numri i qyteteve	1
5	Numri i fshatrave	2
6	Numri i banorëve	5,600
7	Numri i familjeve	1450
8	Popullsia në gjendje fizike pune	48%
9	Buxheti Vjetor - 2008	41,135,000 Lekë
10	Të Ardhurat Vendore të Pritshme - 2008	11,687,000 Lekë
11	Numri i Bizneseve Private	146
12	Niveli i Papunësisë	30%
13	Numri i të punësuarve në sektorin shtetëror	628
14	Numri i të punësuarve në sektorin privat	152
15	Niveli i emigracionit	Nuk ka të dhëna të sakta
16	Gjatësia totale e rrugëve	26.8 km
17	Numri i Ndërmarrjeve Publike	3
18	Numri i rrjeteve të Ujësjellës-Kanalizimeve	1
19	Numri i të punësuarve në Bashki	29
20	Numri i institucioneve parashkollore	6
21	Numri i shkollave fillore - nëntëvjeçare	3
22	Numri i shkollave të mesme	1
23	Numri total i nxënësve	1450
24	Numri i qendrave shëndetësore	1
25	Numri i spitaleve	1
26	Numri i qendrave të këshillimit	1
27	Numri i qendrave për të moshuar	0
28	Aktivitetet kryesore ekonomike	Dyqane dhe njësi tregtare Njësi shërbimi dhe servise Prerje dhe përpunim druri Bimë mjekësore
29	Dokumente zhvillimi dhe strategji	Strategjia e Zhvillimit Rajonal Plani i Veprimit në Mjedis
30	Nevojat kryesore në Infrastrukturë	Përmirësimi i rrjetit të brendshëm të ujësjellës-kanalizimeve Ndërtimi i pikës së trajtimit të ujërave të zeza Përmirësimi i hapësirave të brendshme të qytetit të Pukës Evidentimi dhe ndërtimi i një pike inxhinierike të mbetjeve Pastrimi i ujëmbledhësve nga ndotja Sistemimi i rrugëve të fshatrave të Bashkisë





## Bashkia Pukë në Kontekstin Rajonal



Dokumenti kryesor referues në të cilin është mbështetur materiali në vazhdim është Strategjia e Zhvillimit Shkodër-Lezhë. Kjo strategji e vë theksin në krijimin e një **“Rajoni Urban Policentrik”** duke ofruar masa për parandalimin e rënies demografike në zonat periferike në lindje të Rajonit. Strategjia e trajton këtë çështje nëpërmjet iniciativave indirekte për rritjen ekonomike në këto zona si dhe përmirësimin e kushteve të jetesës. Në këtë aspekt, Strategjia Rajonale trajton konceptin e **“Stabilizimit të Popullsisë”** të njësive vendore të Pukës, Kurbinit dhe Mirditës duke propozuar planifikimin dhe gjetjen e mundësive financiare për projektimin dhe përmirësimin e infrastrukturave dhe shërbimeve publike ekzistuese, duke trajtuar gjithashtu edhe mundësinë e rivitalizimit të aktiviteteve të ndryshme ekonomike. Një tjetër element specifik i propozuar në Strategjinë Rajonale është zhvillimi i **“Turizmit të Përkrahur”** që në rastin e Bashkisë Pukë i referohet kushteve dhe potencialeve gjeografike dhe natyrore që ka kjo zonë si dhe nevojës që ka biznesi vendor apo operatorët për mbështetjen e autoriteteve në rritjen dhe fuqizimin e këtij sektori. Për zhvillimin e turizmit në zonën e Pukës Strategjia Rajonale propozon promovimin e turizmit natyror familjar në gamën e mundësive të zhvillimit ekonomik. Ndërkohë që propozimet konkrete për këtë sektor prekin çështje të infrastrukturës dhe shërbimeve bazë, pa harruar edhe rritjen e kapaciteteve teknike për turizmin. Propozimet në Strategjinë Rajonale trajtojnë edhe aspektet e mbrojtjes së mjedisit apo përmirësimit të zonave të dëmtuara.

Nga pikëpamja e zhvillimit të infrastrukturave, Strategjia Rajonale fokusohet në konsolidimin e aksit Kukës – Pukë – Vau i Deje – Bushat – Shkodër, si një nga akset e mundshme për krijimin e Korridorit të Zhvillimit Kosovë – Shkodër – Bar. Strategjia promovon rritjen e standardeve të infrastrukturave dhe shërbimeve në Pukë, e cila në këtë aspekt konceptohet si një stacion i rëndësishëm në këtë korridor.

I rëndësishëm për Strategjinë Rajonale Shkodër-Lezhë është zhvillimi i sektorit të pylltarisë dhe produkteve të drurit. E bazuar në potencialet natyrore që kjo zonë ofron në lidhje me këtë sektor, dokumenti në vazhdim integrohet më së miri me Strategjinë Rajonale duke propozuar masa administrative dhe specifitime teknike për ekspertët e fushës.

## Drejtimit e Zhvillimit nga Grupi i Qytetarëve

1. Zhvillimi i Turizmit Malor si një oportunitet i mundshëm për shkak të karakteristikave dhe vlerave natyrore malore që ofron territori i Pukës.
2. Promovimi dhe zhvillimi i industrisë së përpunimit të drurit duke marrë për bazë pasuritë natyrore pyjore të Pukës si dhe traditat e zonës.




## Vizioni i Zhvillimit të Bashkisë Pukë

**Puka** si një qendër e rëndësishme urbane e integruar në realitetin e ri/ardhshëm rajonal në veri të Shqipërisë; një urë lidhëse për njerëzit, aktivitetet e ndryshme ekonomike dhe shërbimet midis Shkodrës dhe Kosovës;

**Puka** si një qytet i zhvilluar ekonomikisht që mbështetet në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe potencialeve pyjore dhe në turizmin malor.

**Puka** si një Bashki me burime njerëzore të kualifikuara dhe të ripërtërira, si në nivelin e administratës vendore edhe në strukturat e sipërmarrjes së biznesit, kulturës, sportit dhe arsimit; që nxisin krijimin e një klime të favorshme për biznesin vendas dhe të huaj dhe të mundësive për punësim dhe rritje të qëndrueshme të të ardhurave për banorët;

**Puka** një vend i sigurt, i pastër dhe tërheqës për banorët dhe komunitetet në rritje, të cilët kanë mundësi të përmirësojnë shëndetin dhe mirëqenien e tyre, në bashkëveprim dhe me sens qytetar, dhe me kapacitetin dhe shtysën për të dhënë kontribut efektiv në të ardhmen e Bashkisë dhe qytetit.



## Objektivat e Përgjithshëm të Zhvillimit të Bashkisë Pukë



### **A. NË FUSHËN E ZHVILLIMIT EKONOMIK;**

Zhvillimi ekonomik i Bashkisë Pukë duke u përqendruar në përmirësimin e klimës së biznesit, promovimin e aktiviteteve vendore të sipërmarrjes dhe krijimin e një mjedisi tërheqës për investitorët e huaj.

### **B. NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË TERRITORIT;**

Konsolidimi i qendrës urbane të qytetit të Pukës si dhe përmirësimi i cilësisë së hapësirave të brendshme urbane në funksion të promovimit dhe zhvillimit të karakterit turistik malor të qytetit.

### **C. NË FUSHËN E PËRMIRËSIMIT TË INFRASTRUKTURËS DHE SHËRBIMEVE;**

Rritja e cilësisë së shërbimeve publike dhe infrastrukturës fizike dhe sociale në të gjithë territorin e Bashkisë Pukë.

### **D. NË FUSHËN E PËRMIRËSIMIT TË QEVERISJES VENDORE;**

Rritja e kapaciteteve menaxhuese dhe administruese të pushtetit vendor në Bashkinë Pukë.

### **E. NË FUSHËN E RITJES SË TË ARDHURAVE VENDORE;**

Rritja e të ardhurave vendore në Bashkinë Pukë duke mundësuar kështu më shumë investime në infrastruktura dhe shërbime.

## Zhvillimi Ekonomik

### **A1. Mbështetjen dhe nxitjen e aktiviteteve të vogla ekonomike në Bashkinë Pukë duke u fokusuar në traditat ekzistuese artizanale dhe prodhimin e bimëve mjekësore e produkteve të drurit:**

- a. Identifikimi i potencialeve të prodhimit të këtyre produkteve artizanale në territorin e Bashkisë Pukë
- b. Mbështetja ndaj biznesit të vogël ekzistues artizanal dhe prodhues në Bashkinë Pukë

### **A2. Mbështetjen dhe zhvillimin e Turizmit Malor duke u bazuar në karakteristikat natyrore të veçanta të Bashkisë Pukë**


- a. Nxitja dhe Zhvillimi i aktiviteteve turistike në këtë Bashki

### **A3. Promovimin dhe Zhvillimin e Aktiviteteve Ekonomike në territorin e Bashkisë Pukë.**

- a. Vendorsja e bashkëpunimit me komunat fqinje si edhe me Qarkun e Shkodrës me qëllim nxitjen dhe zhvillimin e aktiviteteve ekonomike
- b. Përgatitja e projekteve të detajuara për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike
- c. Mbështetja me investime konkrete

### **A4. Mbështetjen dhe zhvillimin e prodhimit dhe të aktiviteteve bujqësore vendore**

- a. Evidentimi i potencialeve të prodhimit të këtyre kulturave bujqësore në territorin e Bashkisë Pukë
- b. Përmirësimi i përdorimit të tokës dhe infrastrukturave mbështetëse nëpërmjet një studimi për vlerësimin e nevojave në lidhje me investime
- c. Rritja e mbështetjes teknike dhe financiare ndaj fermerëve vendas në Pukë





## Menaxhimi i Tokës

### **B1. Mbrojtja e tokës dhe parandalimi i ndërtimeve pa leje**

- a. *Rritja e nivelit të kontrollit mbi ndërtimet e reja (Inspektorati i Ndërtimit) në territorin e Bashkisë Pukë*
- b. *Prezantimi dhe konsolidimi i masave penalizuese si dhe njohja e komunitetit vendor me këto masa.*
- c. *Identifikimi i politikave fiskale të posaçme për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe pyjeve dhe orientimi i ndërtimeve në këto territore*

### **B2. Rigjallërimi i territoreve ekzistuese të dëmtuara nga aktiviteti njerëzor si dhe mbrojtja e mjedisit në Bashkinë Pukë**

- a. *Identifikimi i zonave që kanë nevojë për ndërhyrje përmirësuese në mjedis*
- b. *Përmirësimi i gjendjes së mjedisve të dëmtuara (ndotura) në territorin e Bashkisë Pukë*

## Përmirësimi i Infrastrukturave dhe Shërbimeve

### C1. Përmirësimin e gjendjes së rrjetit rrugor në Bashkinë Pukë

- a. Hartimi i projekteve të ndërhyrjes në rrjetin rrugor të qytetit dhe të fshatrave të Bashkisë Pukë
- b. Kryerja e investimeve përmirësuese për rrjetin rrugor të qytetit

### C2. Përmirësimin e gjendjes së ujësjellës-kanalizimeve në territorin e Bashkisë Pukë

- a. Përmirësimi i kushteve teknike dhe menaxhuese të Drejtorisë së Ujësjellës-Kanalizimeve në Bashkinë Pukë
- b. Përmirësimi i gjendjes fizike të rrjetit të ujësjellës-kanalizimeve në territorin e Bashkisë
- c. Rritja e kapaciteteve të stafit të ndërmarrjes për menaxhimin dhe administrimin e ndërmarrjes

### C3. Përmirësimi i gjendjes së grumbullimit dhe depozitimit të mbeturinave urbane


- a. Identifikimi i një pike për depozitimin e mbeturinave

### C4. Përmirësimi i gjendjes së shkollave dhe kopshteve në territorin e Bashkisë Pukë

- a. Evidentimi i nevojave për përmirësime fizike në shkollat e Bashkisë Pukë
- b. Përgatitja e projekteve teknike për financime të mundshme nga sektori shtetëror apo donatorë të ndryshëm
- c. Nxitja e forumeve vendore lidhur me mundësinë e rritjes së cilësisë së mësimdhënies në shkollat e Bashkisë

### C5. Gjelbërimi i mjediseve në Bashkinë Pukë

- a. Përmirësimi i kushteve fizike të mjediseve të gjelbra në territorin e Bashkisë



## Forcimi i Qeverisjes së Mirë

### **D1. Rritja e kapaciteteve të Bashkisë Pukë**

- a. *Riorganizimi administrativ i Bashkisë Pukë*
- b. *Rritja e kapaciteteve teknike të staft të Bashkisë*

### **D2. Përmirësimi i transparencës në proceset vendore të vendimmarrjes**

- a. *Shpërndarja zyrtare e informacionit lidhur me aktivitetet e Bashkisë Pukë*
- b. *Nxirtja e pjesëmarrjes qytetare dhe informimi në mbledhjet e këshillit bashkiak*

### **D3. Zhvillimi i buxhetimit me pjesëmarrje në bashkinë Pukë**

- a. *Ngritja e kapaciteteve vendore për organizimin e Buxhetimit me Pjesëmarrje në Pukë*
- b. *Organizimi i aktiviteteve vjetore periodike të Buxhetimit me Pjesëmarrje në Bashkinë Pukë*

## Mobilizimi i Burimeve Financiare

### F1. Rritjen e të ardhurave vendore të Bashkisë

- a. Krijimi dhe konsolidimi i bazës së të dhënave për rritjen e bazës së taksave dhe tarifave në Bashkinë Pukë

### F2. Promovimi dhe rritja e investimeve të vendit dhe të huaja

- a. Përgatitja e materialeve promovuese për bashkinë Pukë
- b. Organizimi i evenimenteve të ndryshme në mbështetje të biznesit në Bashkinë Pukë

### F3. Evidentimi dhe shfrytëzimi i burimeve të tjera financiare për Bashkinë Pukë

- a. Përgatitja e projekt-propozimeve



## Instrumentat e Menaxhimit të Territorit

Në lidhje me përcaktimin dhe orientimin e shpërndarjes hapësinore të zonave të banimit, zonave mikse si edhe atyre ekonomike në Bashkinë e Pukës, në vijim paraqitet skema grafike me shpjegimet përkatëse.


Qëllimi i saj është që të shprehë nëpërmjet organizimit të hapësirës territoriale objektivat kryesore ekonomike, sociale dhe ambientale të Bashkisë Pukë. Gjithashtu ato janë një instrument kyç për pjesëmarrjen e publikut, duke i ofruar qoftë aktoreve privatë apo publik mundësinë për të bashkëvepruar bazuar në një vision të qartë dhe të integruar.

- ❖ Të drejtojnë përdorimin e përgjithshëm të tokës duke përcaktuar kornizat për zhvillimin territorial të Bashkisë Pukë.
- ❖ Të përcaktojnë zonat të mbrojtura natyrore
- ❖ Të përcaktojnë zonat mikse si dhe ato ekonomike

### A. Zonat e banimit

Zonat e banimit të paraqitura në hartë ndahen në dy lloje:

1. Në llojin e parë është e përfshirë **Zona e Konsolidimit Urban**, e cila ka nevojë dhe është subjekt për hartimin e planeve të përgjithshme rregulluese në të ardhmen, të mastër planeve tematike apo studimeve të tjera specifike (si psh studime të detajuara pjesore etj...). Në të njëjtën kohë kjo zonë ka nevojë të plotësohet me gjithë infrastrukturën fizike dhe sociale të nevojshme për një zonë banimi dhe shërbimet përkatëse (rrjeti rrugor, sistemi i kanalizimeve, furnizimi me ujë dhe energji elektrike, transporti publik, shkolla, kopshte, qendra shëndetësore e sociale etj...). Dendësia e banimit bruto dhe ajo neto do të propozohen nga plani rregullues i ardhshëm. Në këtë zonë propozohet të lejohen dhe inkurajohen (duke u bazuar në politikat vendore përkatëse) ndërtime të reja me qëllim konsolidimin e zonës dhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve publike.





2. Në llojin e dytë janë të përfshira **Zonat Urbane Rurale**, të cilat paraqesin nevojë për plane të përgjithshme rregulluese dhe analiza të mirëfillta urbane për të dalë në konkluzione dhe rekomandime teknike të qarta për një vlerësim të të gjithë zones së Pukës dhe rrethinave të saj.

Këto propozime për orientim kanë si objektivi:



- ❖ Të ndihmojnë në konsolidimin e zonës urbane.
- ❖ Të ndihmojnë në ruajtjen dhe rehabilitimin e zonave me vlera natyrore e pejsazhistike.
- ❖ Të ndihmojnë në dendësimin dhe rritjen e efijçencës së shërbimeve në zonën urbane.
- ❖ Të ndihmojnë në uljen e kostove të investimeve dhe të mirëmbajtjes së infrastrukturave në zonën urbane e më tej.
- ❖ Të përcaktojnë kategoritë e përdorimit të tokës.

### **B. Zonat specifike:**

Zonat specifike të paraqitura në hartë ndahen në dy lloje:

- ❖ **Zonat ekonomike:** këtu do të nënkuptojmë zonat e destinuara për zhvillimin e tregtisë, industrisë së lehtë të përpunimit të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale të zonës dhe si dhe shërbimëve përkatëse. Në rastin e Bashkisë Pukë këto zona do të jenë subjekt I studimeve mjedisore te plota për të plotësuar një raport të detajuar për ndikimin që kanë në mjedis .
- ❖ **Zonat e gjelbra me vlera mjedisore e panoramike:** këtu përfshihen e gjithë kurora e gjelbër e qytetit zona, përreth rezervuarit Kukaj, liqeni I vogel I qytetit mbrapa spitalit, pista e skive etj. Këto janë zona të cilat duhet të mbrohen me vendime të këshillit bashkiak, sepse këto zona të gjelbra kërkojnë një vëmendje të veçantë për tu mbrojtur nga erozioni, prerjet pa kriter, hedhja e mbeturinave etj.

Këto instrumenta të paraqitura në mënyrë skematike orientojnë studimet e sipërpërmendura në bazë të prioriteteve dhe të planeve të veprimit siç përcaktohen në këtë Plan Strategjik.





## Forma dhe Metodologjia e Zbatimit të PSZH

Bashkia Pukë, nëpërmjet Kryetarit dhe administratës vendore, është përgjegjësjë kryesore për zbatimin e Planit Strategjik të Zhvillimit. Për të rritur eficiencën e këtij procesi është e nevojshme marrja e masave si më poshtë:


- Të ngrihet grupi i zbatimit dhe monitorimit të Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Pukë, brenda strukturës administrative ekzistuese, i cili do të jetë përgjegjësi kryesor për koordinimin dhe zbatimin e nismave dhe aktiviteteve të propozuara në Planin e Veprimit. Në varësi të buxhetit të Bashkisë, grupi mund të përbëhet nga përfaqësues të zyrave të ndryshme të administratës apo edhe nga specialistë të angazhuar rishtas në këtë strukturë. Në të dy rastet grupi duhet të jetë nën lidhshirë të kryetarit të Bashkisë. Në këtë mënyrë sigurohet vazhdimësia dhe lidhja e Planit Strategjik të Zhvillimit me proceset e planifikimit dhe buxhetimit vjetor.
- Konsolidimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve të Departamentit të Koordinimit Zhvillimit në Bashkinë Pukë, i cili do të angazhohet me përgatitjen e studimeve dhe projekt-propozimeve të nevojshme për financim në funksion të aktiviteteve të propozuara sipas çdo fushe.
- Riorganizimi administrativ i Bashkisë Pukë duke u bazuar në veprimet dhe kërkesat e identifikuar në Planin e Veprimit të propozuar si p.sh. krijimi i grupeve të punës për përgatitjen e projekt-propozimeve, organizimi dhe monitorimi i seminareve apo takimeve me pjesëmarrjen e aktorëve vendorë për çështje të buxhetimit, arsimit, bujqësisë, mjedisit etj; organizimi dhe moderimi i "shoqërive funksionale" në bashkëpunim me njësitë vendore fqinje etj..

- Fokusimi në forcimin e strukturave administrative që merren me ndjekjen e angazhimeve strategjike në kuadër të Planit Strategjik të Zhvillimit si dhe monitorimin e performances.
- Përmirësimi i bazës së të dhënave territoriale, financiare dhe infrastrukturore në Bashki për t'i paraprirë përgatitjes së një serie projektesh apo studimesh të nevojshme për zbatimin e mundshëm të Planit Strategjik të Zhvillimit.
- Rritja e kapaciteteve dhe nivelit të angazhimit të stafit të Bashkisë Pukë sidomos në aspektin e menaxhimit dhe monitorimit të territorit dhe infrastrukturave fizike nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme apo edhe përmirësimit të sistemit të raportimit dhe vlerësimit.
- Institucionalizimi i raporteve periodike të çdo zyre të administratës lidhur me ecurinë e zbatimit të Planit Strategjik të Zhvillimit.

Zbatimi i suksesshëm i Planit Strategjik të Zhvillimit në Bashkinë Pukë ka nevojë për konsolidimin e një sistemi të mirëfilltë monitorimi dhe vlerësimi periodik. Në këtë mënyrë bëhet i mundur evidentimi i problemeve që mund të hasen gjatë zbatimit të Planit të Veprimit si dhe të përcaktohen ndryshimet apo adaptimet e nevojshme. Plani Strategjik i Zhvillimit i referohet një periudhe të shkurtër kohore – 2008-2014 – dhe në këtë mënyrë është tepër e rëndësishme që të shoqërohet me një proces të vazhdueshëm vlerësimi dhe përshtatjesh të nevojshme.

Duke qenë se Plani është një dokument strategjik në shërbim të Bashkisë Pukë, është e natyrshme që zbatimi dhe monitorimi i tij të kryhen sipas proceseve të funksionimit dhe planifikimit të pushtetit vendor. Kjo mund të thuhet edhe për sinkronizimin e aktiviteteve të propozuara me fazat elektorale të zgjedhjes së pushtetit vendor në Shqipëri. Në këtë mënyrë sigurohet edhe përshtatja e propozimeve të Planit Strategjik të Zhvillimit si dhe monitorimi i zbatimit të saj me ciklet e planifikimit vjetor dhe buxhetimit të administratës.

Bazuar në Ligjin për Financat Publike, përgatitja e Projekt-Buxhetit për tre vitet në vazhdim është një proces që duhet të finalizohet në Muajin Korrik të çdo viti. Ky Projekt-Buxhet bazohet në Udhëzimin e Qeverisë për përgatitjen e Projekt-Buxhetit të të gjitha njësive vendore në periudhën Qershor-Korrik. Ky Projekt-Buxhet parashikon shpenzimet dhe investimet e Bashkisë Pukë për tre vitet në vazhdim, ndërsa Plan-Buxheti, që përgatitet dhe miratohet nga Këshilli Vendor si dhe nga Prefektura Shkodër brenda Dhjetorit, trajton vetëm vitin pasardhës. Përgatitja e Projekt-Investimeve për Grantet Konkurruese është një proces që duhet të përfundojë deri në 1 Nëntor të çdo viti. Plan-Buxheti vjetor mund ose jo të përfshijë këto projekte në strukturën e tij.



Skema e Propozuar e Monitorimit të Strategjisë së Zhvillimit

Aktiviteti i Propozuar	Afati Kohor (për çdo vit)	Aktorët Përgjegjës	Lidhja me Planifikimin dhe Buxhetimin Vjetor
Vlerësimi 6-mujor i aktiviteteve të Planit të Veprimit të PSZH-së. Përgatitja e Progres-Raportit.	Prill - Maj	Njësia e Koordinimit dhe Zhvillimit	Duke u bazuar në rezultatet e 6-mujorit, Bashkia mund të përcaktojë ndryshimet në Projekt-Buxhetin që dorëzohet në Korrik.
Takime publike me qytetarët për rezultatet e zbatimit të PSZH-së.	Qershor - Korrik	Njësia e Koordinimit dhe Zhvillimit	Ndikojnë në adoptimet e nevojshme të aktiviteteve në Plan-Buxhetin final
Takim i stafit të administratës së Bashkisë për të diskutuar progresin si dhe ndryshimet e nevojshme.	Tetor - Nëntor	Njësia e Koordinimit dhe Zhvillimit - Kryetari i Bashkisë	Takimi do të finalizojë ndryshimet dhe adoptimet e nevojshme të Planit të Aktiviteteve që do të reflektohen në Buxhetin e ri vjetor të Dhjetorit.
Takim vjetor për Vlerësimin dhe Monitorimin e PSZH-së. Përgatitja e Raportit Vjetor	Nëntor	Njësia e Koordinimit dhe Zhvillimit – Kryetari i Bashkisë	Takimi final i paraprin finalizimit dhe dorëzimit të Buxhetit Vjetor të Bashkisë.

Në fund të çdo vlerësimi Grupi i Punës duhet të dorëzojë një raport përmbledhës i cili do të paraqitet para Këshillit të Bashkisë Pukë. Ky i fundit ruan të drejtën që, për çdo rast, të bëjë kërkesë për raportim shtese nëse e gjykon të nevojshme.

# PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË BASHKISË PUKË

P ë r m b l e d h j e